

Agim VELIU,
Minister i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

I çmuari z. President i Kosovës,
I nderuari Kryetar i Akademisë së Shkencave e Arteve të Kosovës, z. Rexhep Ismajli,
I nderuari kryesues z. Jusuf Bajraktari,
I nderuari Kryetar i Kuvendit të Kosovës
I nderuar z. Kryeministër,
Mysafirë të nderuar,
Pjesëmarrës të këtij simpoziumi,
Zonja e Zotërinjë,

Është nder dhe privilegj i veçantë që në emër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës e Teknologjisë dhe në emrin tim, t'i përshëndes punimet e këtij simpoziumi kushtuar 600 vjetorit të lindjes së kryeheroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti.

Është thënë e shkruar shumë për Skënderbeun, për atë "strallin që bën dritë në mbamendjen tonë historike, me idealin e të cilit u identifikua kombi shqiptar", por edhe 6 shekuj pas epokës së tij, shqiptarët e kanë për nder të identifikohen me trimin legjendar që duke mbrojtur Shqipërinë u vu në mbrojtje të qytetërimit evropian.

Që nga Barleti e deri më sot janë botuar qindra botime për personalitetin njerëzor, ushtarak, diplomatik, patriotik të Gjergj Kastriotit, 600 vjet pas lindjes së tij, ka ende çka të flitet për qenien e tij luftarake e atdhetare. Sidomos sot, kur pjesë e gjeografisë së atdheut



të ndarë duhet të bëjë hapat që Skënderbeu i pat bërë në Lezhë me Lidhjen e Princave Shqiptarë.

Për shqiptarët gjithandej trojeve etnike, figura patriotike dhe personaliteti prej udhëheqësi i kryetrimt tonë kombëtar, mbeten frymëzim i fuqishëm për të vazhduar me ndriçimin e epokës së tij.

Asaj epoke për të cilën studiues vendorë e ndërkombëtarë pajtohen që ka emrin e Gjergj Kastriotit dhe vulën meritore prej mbrojtësit të qytetërimit perëndimor!

Pjesëmarrës te nderuar,

Simpoziumi ndërkombëtar kushtuar 600 vjetorit të lindjes së Skënderbeut, ka simbolikën e shumëfishtë që Prishtinës e Kosovës i jep madhështinë e Hyut vetëm, për shqiptarët reflekton domosdoshmërisht filozofinë e unifikimit të qenies shpirtërore e mendore.

Kam besim të thellë se gjatë aktiviteteve në vijim, ju do të hidhni dritë të re për epokën e madhe të tribunit që nderoi Shqipërinë e shqiptarët dhe civilizimin evropian.

Shqiptarët dhe Kosova kanë dëshmuar e po provojnë se ishin dhe janë pjesë e natyrshme e kulturës dhe e qytetërimit evropian.

Është në radhë që Evropa dhe bota ta çmojnë rolin e udhëheqësit të lëvizjes çlirimtare i cili 6 shekuj më parë mbrojt i fuqishëm vlerat njerëzore dhe lirinë tonë, të cilën edhe Kosova e sotme e dëshiron për ta ndërtuar ardhmërinë dhe pavarësinë e saj.

Le të jetë ky simpoziум ndërkombëtar, një hap shkencor para për të ndriçuar epokën e Gjergj Kastriotit, por edhe një synim për të treguar shpirtin liridashës të shqiptarëve dhe Kosovës veçantë!

Puna e vazhdueshme shkencore e Akademisë së Shkencave dhe Arteve, Institutit të Historisë dhe elitës intelektuale të Kosovës, ky simpoziум ndërkombëtar, janë ai zëri jehues që shenjtërisht shpreh angazhimin e intelektualëve për lirinë e Kosovës edhe sot.

Duke ju uruar punë të mbarë, më lejoni t'ju falënderoj për kontributin Tuaj.

Falënderim dhe urim për jetë të gjatë edhe Presidentit Rugova nën patronatin e të cilit ndodhë ky eveniment madhështor!

Ju faleminderit!